

KËRKESË
Nr.4962, datë 1.7.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për pasurinë, pronë private, e cila preket si rezultat i ndërtimit të objektit “Lidhja e qytetit Berat-Përmet”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

**LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT DO
TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË OBJEKTIT “LIDHJA E QYTETIT
BERAT-PËRMET”**

Emri Mbiemri	Sip. truall	Çmimi/m ² truall	Sip.arë	Çmimi/m ² arë	Objekt vlera në lekë	Drufrutorë vlera/lekë	Shuma totale
Petrit Dobroniku	150 m ²	1831 lek/m ²	200 m ²	851 lek/m ²	2 193 973	77 500	2 716 323

Vlera totale e shpronësimit është 2 716 323 (dy milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet e tre) lekë.